

Raporti ditor i monitorimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të

Përpara prezantimit të të dhënave faktike mbi procesin e monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për pasqyrimin e fushatës zgjedhore 2021, ju informojmë se:

TV Saranda; TV Klaudiana; TV 4+ dhe TV Gold nuk kanë depozituar në AMA edhe më datë 15.04.2021 regjistrimet e përmbajtjeve audiovizive të një dite më parë.

AMA rikujton këto subjekte, por dhe të tjera, të njoftuara nga AMA në mënyrë të përsëritur, me shpresë zyrtare dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta, se duhet që të zbatojnë sistematikisht kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të miratuara nga KQZ. Përmbajtjet e regjistruara duhet të depozitohen në AMA brenda orës 10:00 të ditës së nesërme të transmetimit.

TV Bulqiza, në mënyrë të përsëritur, ka transmetuar dhe më datë 15.04.2021, ora 15.00, edicionin informativ të një OSHMA-je tjetër. Subjekti ka marrë njoftime nga AMA që ta ndërpresë një praktikë të tillë.

Kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, neni 84, pika 7, OSHMA-të:

TV Top News	08:55, 09:23, 14:00, 19:33
TV MCN	20:31, 20:32, 20:41, 20:42
TV Shijak	11:26, 18:51, 19:58, 20:38.
Kanali 7	18:15
TV Channel 1	08:21, 09:28, 10:12, 11:49, 12:22, 14:25, 19:17, 20:37

Ka transmetuar reklama politike brenda edicionit të lajmeve OSHMA:

Klan News	15:01, 15:07, 15:21, 15:33, 16:03, 16:38, 17:10, 17:21, 17:36, 17:48, 21:34, 21:48, 22:04, 22:18, 23:03, 23:13
-----------	---

Bashkëlidhur gjeni kartelat me gjetjet nga monitorimi për transmetimet e datës 15.04.2021.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Tiranë, më 16.04.2021